

Udhëzimet e aplikimit për çmimet

“Shkencëtar i vitit” për vitin 2018 dhe “Shkencëtar i ri i vitit” për vitin 2018

1. Objektivat

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, ka krijuar një fond për çmime të përvitshme për arritje të jashtëzakonshme kërkimore-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (llogariten rezultatet shkencore nga shtatori i vitit paraprak deri në tetor të vitit aktual). Këto çmime synojnë të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë, të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës.

Emërtimi i çmimeve që do të jepet është: **“Shkencëtar i vitit ”** dhe **“Shkencëtar i ri i vitit”**.

2. Kush mund të nominohet

Mund të nominohen shkencëtarët kosovarë të çdo disipline shkencore që kanë rezultate të shkëlqyera. Nominimi për çmimin vjetor bëhet për rezultate të arritura nga shtatori i vitit 2017 deri në tetor të vitit 2018.

3. Financimi që është vënë në dispozicion

Çmimi “Shkencëtar i vitit”, do të jepet çdo vit për tre shkencëtarët më të suksesshëm kosovarë të disiplinave të ndryshme shkencore. Secili prej tyre do të marrë një çmim prej 2000 eurosh për të mbështetur vazhdimin e karrierës së tyre kërkimore-shkencore dhe për të bërë të mundur që fituesit e çmimit të ndërtojnë, konsolidojnë ose drejtojnë nisma të tjera kërkimore-shkencore.

Çmimi “Shkencëtar i ri i vitit”, konsiston në një shpërblim monetar prej 1500 euro dhe do të jepet çdo vit për tre shkencëtarët kosovarë të disiplinave të ndryshme shkencore që janë në hapat e tyre të parë të karrierës kërkimore dhe që në vitin paraprak kanë arritur rezultate kulmore kërkimore-shkencore.

4. Afatet

Aplikimet duhet të dorëzohen në MASHT - Zyra e arkivit deri me datë 10 dhjetor 2018, në ora 16:00.

5. Kriteret e pranimit

5.1. Kandidati për titullin “Shkencëtar i vitit” duhet:

- Të jetë shtetas i Kosovës ;
- Punën dhe rezultatet kulminante të tij t’i ketë arritur në institucionet kërkimore-shkencore të Kosovës.

5.2. Kandidati për titullin “Shkencëtar i ri i vitit” duhet:

- Të mos jetë më i vjetër se 30 vjeç;
- Të jetë shtetas i Kosovës.

5.3. Një shkencëtar çmimin mund ta merr vetëm njëherë në karrierë.

Çmimet jepen vetëm për individë. Nëse arrijtet në punën kërkimore-shkencore kanë ardhur si rezultat i bashkëpunimit të dy ose më shumë personave, atëherë kërkohet që individët e përfshirë të propozojnë kandidatura të veçanta duke vënë në dukje rolin specifik të tyre në punën kërkimore-shkencore.

6. Kërkesat e aplikimit

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përmbajë:

1. **Formularin e aplikimit**, ku të jetë përfshirë emri i aplikuesit/kandidatit, universiteti ose institucioni kërkimor i tij/saj, një **deklaratë shpjeguese** që përshkruan domethënien e arritjeve të kandidatit në punën kërkimore-shkencore gjatë vitit paraprak dhe impakti ose kontributi që ai/ajo ka dhënë në fushën e vet shkencore. Duhet marrë parasysh kriteret e vlerësimit të përmendura më sipër. Gjithashtu, duhet të demonstron veçantia dhe origjinaliteti i punës kërkimore-shkencore të tij/saj dhe të tregohet se ajo është më e rëndësishme se punët kërkimore-shkencore të tjera të bëra në këtë fushë.

2. **Biografia (Curriculum vitae (CV))** të kandidatit, jo më të gjatë se 3 faqe.

3. **Listën e plotë të botimeve** të kandidatit.

4. **Përmbledhjen e arritjeve profesionale** (për shembull listën e botimeve a patentave më të rëndësishme të kandidatit, datat e botimeve, citimet e botimeve, faktorin e ndikimit (IF) të revistës shkencore) si dhe të dhëna të tjera relevante.

5. Aplikimi duhet të shoqërohet nga **3 rekomandime** (jo më të shkurtra se dy faqe) nga shkencëtarë të tjerë apo institucioneve kërkimore-shkencore.

Aplikimi duhet të dorëzohet personalisht, me korrier ose me postë në një zarf të mbyllur, ku të jenë shkruar fjalët “Aplikimi për çmimet” në adresën: MASHT – Zyra e arkivit rr. “Agim Ramadani” p. n. 10000 Prishtinë, Kosovë.

Gjithashtu, aplikimi duhet dorëzuar brenda afatit edhe në version elektronik më së largu deri më **10.12.2018 (e hënë)** në orën **16:00** në adresën elektronike sebahate.jupolli@rks-gov.net.

Aplikimi duhet të jetë i përgatitur në gjuhën shqipe, gjuhën angleze apo gjuhën serbe.

Nëse formularët nuk janë plotësuar tërësisht, nuk do të merren në shqyrtim.

7. Kriteret e vlerësimit dhe procedura e aplikimit

MASHT do të ndërmarrë një kontroll formal të aplikimit. Aplikimet që nuk janë të plota, ato që nuk janë në përputhje me rregullat e MASHT-it ose ato që kanë mangësi formale, nuk do të merren parasysh.

Aplikimet për përfituesit e mëhershëm të çmimit nuk merren parasysh.

Do të kontrollohen gjithashtu kriteret e përgjithshme të pranimit që përmenden në vijim:

- Propozimi duhet dorëzuar brenda afatit të shpallur (merret parasysh data e vulës së postës) nëpërmjet postës ose duke e dorëzuar personalisht, njëherazi edhe me postë elektronike në adresë email-i sebahate.jupolli@rks-gov.net.

Propozimi duhet të jetë i plotë dhe në përputhje me strukturën e dhënë.

Fituesit e çmimeve do të përzgjidhen prej një paneli vlerësues të përbërë nga këshillat e fushave përkatëse shkencore si dhe nga Këshilli Shkencor i MASHT. Gjatë përzgjedhjes, këshillat e fushave shkencore dhe Këshilli Shkencor i MASHT do të përdorin kriteret e mëposhtme:

- Reputacioni i kërkuesit (është e rëndësishme që kandidati të ketë punime të botuara në revista shkencore ndërkombëtare apo botime të veçanta që janë vlerësuar ose të ketë dhënë një kontribut të veçantë në zhvillimin e një fushe të caktuar shkencore).
- Origjinaliteti dhe cilësia e punës kërkimore-shkencore.
- Puna kërkimore-shkencore është novatore (domethënë e re dhe e pahulumtuar më parë).
- Kandidati tregon nivel të lartë kreativiteti, mënyrë të re të menduarit dhe aplikon qasje të re.

Kritere shtesë për çmimin “Shkencëtar i vitit”

- Suksesi i arritur në sigurimin e fondeve për punë kërkimore-shkencore nga jashtë.
- Dhënia e një kontributi domethënës për vënien e punës kërkimore-shkencore në të mirë të shoqërisë dhe/ose ekonomisë.
- Origjinaliteti dhe cilësia e punës kërkimore-shkencore.
- Puna kërkimore-shkencore është novatore (domethënë e re dhe e pahulumtuar më parë).
- Kandidati tregon nivel të lartë kreativiteti, mënyrë të re të menduarit dhe aplikon qasje të re (novatore).

MASHT, inkurajon dhe përkrahë nominimin e shkencëtareve femra.

Informacion shtesë

Formularët e nevojshëm dhe dokumentet tjera mund të tërhiqen nga uebfaqja e MASHT-it.

www.masht-gov.net

8. Detajet e kontaktit

Emri: Sebahate Jupolli Safçi

Posta elektronike: sebahate.jupolli@rks-gov.net

Adresa postare: Rr. “Agim Ramadani” p. n. 10000 Prishtinë, Kosovë.

Tel: + 381 (0) 38 213-189